



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:145285
Datë: 07.02.2024
Numri i dokumentit: 05295789

CAP.nr.1712/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit K..... R..... e M..... “P.....”, sh.a, Prishtinë, kundër debitorit B.G., nga Lipjani, Rr. “L..... e P.....”, me bazë juridike përmbartimore-borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, PPP.nr.57/18 të datës 21.06.2023, me datë 07.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e debitorit B.G., nga Lipjani, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, PPP.nr.57/18 i datës 21.06.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.57/18 të datës 21.06.2023, ka hedh poshtë si pa afatshëm prapësimin e debitorit B.G., nga Lipjani, Rr. “L..... e P.....”, i paraqitur ndaj urdhrit të përmbartuesit privat E.M., me seli në Prishtinë, P.nr.XXX/18 të dt.01.10.2018.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, të aprovoj ankesën dhe detyroj kreditorin ne pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste për pagesën e shërbimeve komunale për bartjen e mbeturinave nr.XXXX, lidhur me borxhin në vlerë prej 755.49 euro, për periudhën nga data 01.01.2014 e deri me datën 30.06.2018. Përmbaruesi privat, ka lejuar përmbarimin e kërkuar me urdhrin përmbarimor P.nr.XXX/18 të datës 01.10.2018, kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datë 24.10.2018, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 25.10.2018. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimi dhe përgjigjes në prapësim, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vepruar kur ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.XXX/18 të datës 01.10.2018. Sipas nenit 70 të LPP-së, përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve, pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit 7 ditor. Në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se debitori urdhrin mbi lejimin e përmbarimit e ka pranuar me datën 16.10.2018, ndërsa prapësimin ndaj këtij urdhri e ka paraqitur me datën 24.10.2018, tek përmbaruesi privat E.M. Nga kjo rezulton se prapësimi është paraqitur 1 ditë pas afatit të paraparë ligjor.

Pretendimet ankimore të debitorit sa e i njëjti është i rregullt në pagesën e shërbimeve të kreditorit dhe se ka numër tjetër të konsumatorit dhe se në rastin konkret kemi të bëjmë me konsumator tjetër, Gjykata e Apelit vlerëson se këto pretendime tani për tani nuk mund të shqyrtohen, ngase në rastin konkret gjykata ankimore shqyrton vetëm aktvendimin e atakuar dhe bazën ligjore mbi të cilën është nxjerrë ky aktvendim, pasi që pretendimet e tilla është dashur që të vlerësohen nga gjykata e shkallës së parë, mirëpo meqë në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se prapësimi i debitorit është i paafatshëm, atëherë e njëjta nuk është lëshuar në vlerësimin e këtyre pretendimeve. Duke pasur parasysh të lartcekurat, kjo gjykatë vlerësoj se duhet refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit dhe të vërtetohet aktvendimin e atakuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1712/2023 me datë 07.02.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti